

**FATMIRA MUSAJ**

**ARSIMI NË SHQIPËRI DHE MASAT  
PËR PËRMIRËSIMIN E TIJ  
(1925-1928)**

Në numrin e kaluar, në studimin “Arsimi në Shqipëri dhe masat për përmirësimin e tij (1925-1928)”, është trajtuar gjendja arsimore në Shqipëri në vitet 1924-1925, masat me karakter politik, organizativ e juridik të marra nga qeveria shqiptare dhe përpjekjet e Drejtorisë së Përgjithshme Arsimore (DPA) për zbatimin e tyre.

**Më shumë vëmendje për arsimin: Plotësimi  
dhe zbatimi i kuadrit ligjor**

Drejtoria e Përgjithshme Arsimore, si institucioni më i lartë i arsimit në Shqipëri, ishte një strukturë e përkohshme. Detyrat që shtroheshin para arsimit kombëtar si: zbatimi i legjislacionit të miratuar për formimin dhe konsolidimin e arsimit unik kombëtar, rritja e kuadrit arsimor e kualifikimi i vazhdueshëm i tyre, përgatitja dhe botimi i teksteve shkollore dhe zgjerimi i vazhdueshëm i rrjetit shkollor, kërkonin një institucion qendror arsimor me kompetenca dhe kapacitete njerëzore më të zgjeruara. Stabilizimi politik i vendit dhe përmirësimi i buxhetit të shtetit (nga 15.764.322 franga ar, në vitin 1925, në 30.838.139 franga ar në vitin 1927),<sup>1</sup> bëri të mundur që në qershor 1927, me vendim të Këshillit të Ministrave (KM), të kalohej nga DPA në Ministri të Arsimit (MA).<sup>2</sup>

Në krye të këtij dikasteri u emërua Xhafer Ypi. Në letrën shoqëruese të emërimit, presidenti A. Zogu i kërkoi ministrit të punonte për zhvillimin e arsimit kombëtar në mënyrë që në shkollë të fitonte rregulli, disiplina dhe fryma kombëtare.<sup>3</sup> Arsimin ai e vlerësoi si një burim drite

<sup>1</sup> Teki Selenica, *Shqipëria në vitin 1927*, Tiranë: Shtypshkronja Tirana, 1929, f. LIV.

<sup>2</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: AMPJ), Viti (më tej: V), 1927, Dosja (më tej: D.) 11, fl.3, Telegram i Kryesisë së Republikës drejtuar Xhafer Ypit, me rastin e emërimit si ministër i Arsimit, Tiranë, 29.06.1927.

<sup>3</sup> *Po aty*.

dhe ushqimi për atdhetarizmin, i cili u shërbente “si fortesë popujve dhe veçanërisht popujve të vegjël.”<sup>4</sup> Me këtë rast Xh. Ypi në intervistën dhënë “Gazetës Shqiptare”, premtonte se do të punonte për të zhveshur arsimin nga politika, do të përmirësonte ndërtesat shkollore, do të shtrinte arsimin në të gjitha viset e vendit, do të zgjidhte personel arsimor të pajisur me cilësitë e duhura, do të mbështeste me bursa nxënësit e aftë, etj.<sup>5</sup>

Në politikën arsimore Xh. Ypi synonte të zgjeronte arsimin profesional. Për të ofruar mendimin bashkëkohor në organizimin dhe funksionimin e tij, MA solli nga Italia specialistin Kavlini D’Larashi.<sup>6</sup> Por Ypi nuk pati të njëjtin mendim dhe për arsimin e mesëm teorik (gjimnazi, liceu). Ai gjykonte se gjimnazet ishin shumë për numrin e popullsisë që kishte Shqipëria. Por, më tepër se një argument i tillë atë e trembte ndjeshmëria e intelektualëve ndaj prirjeve demokratike në zhvillimet shoqërore. Nisur edhe nga përvoja e ngjarjeve të kaluara, ai e shihte kontingjentin e këtyre shkollave si kërcënim për regjimin, sepse, sipas tij “...ata do të sjellin, dëme, kokëçarje e demoralizim për vendin.”<sup>7</sup> Mentaliteti konservator i tij binte ndesh me nivelin arsimor, formimin intelektual dhe përvojën si nëpunës i administratës shtetërore.\* Në të njëjtën kohë mendimi i tij ishte i gabuar, sepse do të kufizonte numrin e nxënësve të aftë për të ndjekur studimet jashtë vendit, do të frenonte perspektivën për rritjen e mëtejshme të inteligjencies shqiptare për të cilët arsimi, administrata në tërësi si dhe zhvillimi ekonomik i vendit, kishin shumë nevojë.

Në zbatim të kësaj politike Xh. Ypi, në vitin 1928 vendosi të mbyllte liceun e Gjirokastrës.<sup>8</sup> Kjo shkaktoi pakënaqësi në radhët e intelektualëve dhe veçanërisht te mësuesit e liceut. Ata u shprehën se ekzistenca dhe funksionimi i tij, ishin shumë të rëndësishëm për rininë e këtij qyteti.

<sup>4</sup> *Po aty.*

<sup>5</sup> *Gazeta Dielli*, nr.3093(686), 12 gusht 1927, f.3. Intervistë e Xh. Ypit dhënë *Gazetës Shqiptare*, Bari, Itali.

<sup>6</sup> *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F) Nënprefektura e Kavajës, V. 1928, D.137, fl.1, Telegram i nënprefektit të Durrësit drejtuar nënprefeturës së Kavajës, Durrës, 11.08. 1928.

<sup>7</sup> *Po aty.*

\* Xh. Ypi, kishte kryer studimet e larta në Universitetin e Stambollit për drejtësi. Shërbeu si nëpunës në administratën osmane. Erdhi në Shqipëri pas Shpalljes së Pavarësisë dhe u inkuadrua në jetën politike të vendit.

<sup>8</sup> *AMPJ*, V.1928, D. 280, fl.1; *Gazeta Demokratia*, 7 korrik 1928, f.2.

Protesta e tyre u përkrah edhe nga mësuesit e gjimnazit të Tiranës, gjë që e detyroi ministrin e Arsimit të anulonte vendimin.<sup>9</sup>

Vëmendje e veçantë në periudhën e presidencës së Ahmet Zogut iu kushtua shkollimit të femrës sidomos në arsimin profesional. Mbështetur në përvojën amerikane Ypi synonte të hapte shkolla për vajza ku të mësonin mjeshteri praktike, teknike e bujqësore. Kjo çështje kishte zënë vend në politikën arsimore të qeverisë shqiptare. Në janar të viti 1926, A. Zogu në fjalën para Asamblesë tërhoqi vëmendjen për gjendjen e rëndë arsimore të femrës dhe veçanërisht të asaj në zonat rurale dhe kërkoi çeljen e shkollave femërore në fshat, rritjen e frekuentimit prej tyre edhe në shkollat e përziera dhe ato profesionale.<sup>10</sup> Për këtë ai propozoi që të ngrihej dega normale pranë shkollës Amerikane të Kavajës për përgatitjen e arsimtareve, e cila filloi aktivitetin në vitin shkollor 1926-1927.<sup>11</sup>

Në të njëjtën kohë DPA, për vitin shkollor 1926-1927, bëri marrëveshje me drejtoritë e shkollave private si me atë të shkollës Amerikane në Kavajë, të institutit “Kyrias” në Tiranë, të shkollës Stigmantine në Shkodër, që në degët Normale të këtyre shkollave, të shkolloheshin vajzat të cilat mbështeteshin me bursa nga shteti.<sup>12</sup> Drejtoria e institutit “Kyrias” ofroi mundësinë për të shkolluar 50 vajza më bursë shteti në vitin shkollor 1926-1927.<sup>13</sup> Për punën serioze pedagogjike që zhvillohej në këtë institut, Aleksandër Xhuvani në vitin 1928 i sugjeroi MA t’i ofronte atij mbështetje financiare për të plotësuar degën normale pedagogjike dhe të kalonte pranë këtij institucioni edhe shkollën Normale të vajzave të Korçës. Në vend të saj, kërkohet të çelëj një lice për vajza ku krahas shkencave shoqërore e të natyrës, të mësohej ekonomi shtëpiake, punëdore dhe muzikë.<sup>14</sup>

Për rolin e rëndësishëm që luante femra në ekonominë e familjes, ishte me interes pajisja e saj me njohuri për bujqësinë. Ndihmesë të vlefshme në këtë drejtim jepte shkolla Bujqësore Amerikane në Kavajë.

<sup>9</sup> *Po aty.*

<sup>10</sup> Fatmira Musaj, *Gruaja në Shqipëri në vitet 1912-1939*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 2002, f. 221.

<sup>11</sup> *Po aty.*

<sup>12</sup> *AQSH*, F.195, V.1926, D.1, fl.182-185, Raport i drejtorisë së Institutit “Kyrias” drejtuar DPA, Tiranë, 15.07.1926; F. Musaj, *Gruaja në Shqipëri ...*, f.230.

<sup>13</sup> *AQSH*, F.195, V.1926, D.1, fl. 182.

<sup>14</sup> *Gazeta Dielli* nr. 4055(748), 16.03.1928, f.4.

Autoritetet shtetërore për të rritur kapacitetin dhe cilësinë e saj, i dhuruan drejtorit të shkollës Telford Erikson (Charles Telford Erickson), 100 akra sipërfaqe toke dhe mjete financiare, për krijimin e një ferme model për të përgatitur specialistë për bujqësinë. Në vitin shkollor 1925-1926, shkolla kishte 52 nxënës, prej të cilëve 21 ishin vajza.<sup>15</sup>

Xh.Ypi bëri përpjekje për zbatimin e ligjeve të miratuara për arsimin, edhe pse qe nën presionin e arsimitarëve e të specialistëve të arsimit, si dhe të shtypit të kohës. Suprimimi i inspektorive në qarqe u vlerësua prej këtyre të fundit si anomali, dhe çrregullim për arsimin kombëtar. Mungesa e tyre kishte dobësuar kontrollin e procesit mësimor që “shumë shpejt, - theksonin ata, - do t’i shihen të metat”.<sup>16</sup> “Gazeta e Korçës” nënvizonte se ky organizim “vërtet i sillte kursim të madh buxhetit të shtetit (60 mijë franga ar shtesë në vit), por dëmi që i shkaktohej arsimit ishte më i madh. Le të mbyllim, - theksonin ata, - edhe shkollat e fshatit të cilat ecnin nën kontrollin e inspektorive, sepse sa më i shpeshtë të jetë kontrolli, aq më i pakët ishte edhe abuzimi.”<sup>17</sup> Detyra e inspektorëve, sipas tyre, ishte e rëndësishme, sepse ndihmonte mësuesit e shkollave fillore të katundeve të malësive, për të përmirësuar metodën e dhënies së mësimin, për programin shkollor dhe çështje të tjera të shkollës.<sup>18</sup>

Zbatimin e ligjit për kategorizimin e arsimitarëve, vetë ata e konsideruan të domosdoshëm për dy arsye: së pari, do të përmirësonte personelin mësimdhënës dhe së dyti, do t’i sillte kurse buxhetit të arsimit, me të cilin do të rregulloheshin pagat e arsimitarëve ashtu siç e parashikonte ligji dhe do të krijonte mundësi për rikrijimin e inspektorive në qarqe. Vendosja dhe shpërndarja e pagave sipas ligjit, do të motivonte arsimitarët në punën e tyre.<sup>19</sup> Gjithashtu u kërkua ulje në kategori të atyre arsimitarëve që nuk kalonin provimin e aftësimin profesional, dhe u

<sup>15</sup> *Po aty*, nr. 4045 (738), 10.02.1928, f.2.

<sup>16</sup> “Inspektoritë e arsimit”, gazeta *Telegraf*, nr. 66, 28 shtator 1927, f. 2.

<sup>17</sup> “Suprimimi i Inspektorive të arsimit”, *Gazeta e Korçës*, nr. 369, 12 prill 1927, f. 2.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të 10 inspektorive në qarqe ishte vendosur në kohën e qeverisë së Lushnjës, e cila kishte marrë si model organizimin e inspektimit të arsimit austro-hungarez në zonat e pushtimit gjatë Luftës së Parë Botërore. Për kontrollin e 150 shkollave ishin ngritur katër drejtorë arsimorë dhe katër inspektorë, në Bicerkë të Shkodrës, Durrës, Elbasan, Berat.

<sup>18</sup> *Po aty*.

<sup>19</sup> “Pse duhet zbatuar ky ligj”?, *Gazeta Telegraf*, nr. 66, 28 shtator 1927, f.3.

propozua ndryshimi i artikullit 4 të ligjit për kategorizimin e arsimtarëve, i cili i lejonte ata të mbanin të njëjtën kategori.<sup>20</sup>

Mbështetur në propozimin e mësipërm, Ministria përgatiti shtojcën e artikullit 4, e cila u dekretua nga Presidenti i Republikës më 28 maj 1928.<sup>21</sup> Për procedurat që do të ndiqeshin për zbatimin e ligjit mbi kategorizimin, u hartua një rregullore e posaçme, e cila u dekretua nga Presidenti në qershor 1928.<sup>22</sup> Ligji organik dhe ai i kategorizimit të arsimtarëve, u zbatuan në vitin shkollor 1928-1929, pasi edhe buxheti për arsimin në këtë vit arriti në 3.202 000 franga ar.<sup>23</sup>

Në korrik të vitit 1928, Xh.Ypi i propozoi Këshillit të Ministrave që të gjitha pasuritë e patundshme, që kishin qenë pronë e institucioneve arsimore qysh nga periudha osmane, të cilat ishin përvetësuar nga institucionet fetare, sipas ligjeve në fuqi t'i ktheheshin MA. Ministri u kërkoi këshillave arsimore pranë pushtetit lokal të kërkonin ndihmë nga prefektët e nënprefektët dhe bazuar në ligjet ekzistuese për pasuritë e patundshme, t'i merrnin ato në zotërim e t'i përdornin për nevoja të arsimit kombëtar.<sup>24</sup> Ato do të përdoreheshin për përmirësimin e financave dhe ambienteve shkollore.

Në vitin shkollor 1927-1928, MA çeli kurse nate kundër analfabetizimit në disa qytete dhe në reparte ushtarake.<sup>25</sup> Për të plotësuar kërkesën për arsimtarë të Komandës së Përgjithshme të Forcave të Armatosura, MA riktheu në punë mësuesit e pushuar për shkaqe politike, por Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) i mbante ata nën vëzhgim, madje kontrollonte dhe korrespondencën e tyre.<sup>26</sup>

<sup>20</sup> *Po aty*.

<sup>21</sup> *AQSH*, F.195, V.1927, D. 27, fl.3; *po aty*, F. 195, V. 1928, D.153, fl. 2, Dekret për miratimin nga Presidenti i Republikës të shtojcës së ligjit për kategorizimin e arsimtarëve.

<sup>22</sup> *Po aty*, F.195, V.1928, D.153, fl.5, Rregullore mbi kategorizimin e arsimtarëve; *Fletorja Zyrtare*, nr. 68, 26 qershor 1928, f. 645.

<sup>23</sup> *AQSH*, F. 195, V. 1927, D.1, fl.1-4; *Fletorja Zyrtare*, nr. 82, gusht 1928, f.795, Ligja organike e arsimit në Shqipëri.

<sup>24</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1928, D. 95, fl.9-11, Propozimi i ministrit të Arsimit mbi pasuritë shkollore drejtuar Këshillit të Ministrave, Tiranë, 5.07.1928.

<sup>25</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1927, D. 358, fl.1, Përgjigje e drejtorive arsimore në Shkodër, Elbasan, Tiranë, qarkores së Ministrisë së Arsimit për emërimin e mësuesve pranë komandave ushtarake, shtator- tetor 1927; Joseph Swire, *Shqipëria - Ngritja e një mbretërie*, Tiranë: Dituria, 2005, f. 396.

<sup>26</sup> *AQSH*, F.152, V. 1927, D. 105, fl. 25, 29, Mbi emërimet mësuesish të pushuar në arsim në Elbasan dhe Tiranë, gusht-tetor 1927; *Po aty*, fl. 62-63.

Në fund të vitit 1927 dhe në fillimin e vitit 1928 u lëvrua përsëri fondi për mbështetje me bursa të studentëve që studionin në degë të ndryshme jashtë vendit, përfshirë dhe ato të shkollave ushtarake.<sup>27</sup> Po këtë vit shkollor në kuadër të forcimit të marrëdhënieve shqiptaro-italiane, u dërguan në Bari, 10 vajza për t'u përgatitur si mami, me bursë të dhënë nga shteti italian.<sup>28</sup>

Qeveria shqiptare në vitet 1925-1928, tregoi kujdes për nxënësit dhe studentët shqiptarë që studionin në shtetet fqinjë. Ajo i kushtoi vëmendje politikës arsimore që ndiqnin veçanërisht Jugosllavia dhe Greqia, në për zgjedhjen e studentëve nga Shqipëria. Pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe veçanërisht pas rimëkëmbjes së shtetit në fillim të viteve '20 të shek. XIX, ato duke anashkaluar institucionet qendrore të shtetit shqiptar, tërhiqnin në mënyrë selektive nxënës dhe studentë, të cilët i mbështesnin me bursë dhe shpresonin që pas studimeve t'i përdornin si përçues të politikave të tyre në Shqipëri.

Për t'i prerë rrugën kësaj praktike, Këshilli i Ministrave në vitin 1926 vendosi që studentët t'i nënshtroheshin procedurave të rregullta shtetërore, ashtu siç veprohej edhe në shtetet fqinje. Në tetor të këtij viti, Këshilli i Ministrave nuk pranoi kërkesën e konsullit grek në Korçë drejtuar kësaj prefekturë, për të lejuar 10 djem të moshës 10-15 vjeç, të studionin me bursë, në shkollën bujqësore të Konicës. Ai vendosi që djemtë shqiptarë do të lejoheshin vetëm atëherë kur qeveria greke do t'i drejtohej Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë.<sup>29</sup>

Në vitin 1928, qeveria u vu në dijeni nga legata në Beograd, se e njëjta politikë arsimore ndiqej edhe nga autoritetet jugosllave. Në mars të këtij viti, Tahir Shtylla sekretar i legatës, konstatonte se për pranimin e djemve në shkolla nga krahina të ndryshme të Shqipërisë, qeveria jugosllave bazohej më tepër në kriterin politik. Për dhënien e bursave nuk

<sup>27</sup> AMPJ, V.1928, D. 292, fl. 8, Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme, Komandës së Përgjithshme të Forcave të Armatosura. Tiranë, shkurt 1928; *po aty*, fl.10, Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme drejtuar Legatës Shqiptare në Athinë, Tiranë, 4 mars 1928; *po aty*, fl.10, Mbështetja e qeverisë shqiptare me bursë të studentëve në Vjenë e Londër; *po aty*, fl. 26, Telegram i Drejtorisë së Shëndetësisë për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Tiranë, 9.VI.1928 .

<sup>28</sup> *Po aty*, fl.1. Telegram i legatës italiane në Durrës, drejtuar Ministrisë së Arsimit, Durrës, 30.12.1927.

<sup>29</sup> *Po aty*, V. 1926, D. 215, fl. 205, Vendim nr. 334 i Këshillit të Ministrave Tiranë, 5.10.1926.

merrej parasysh kapaciteti, mosha e gjendja financiare e studentëve.<sup>30</sup> Sipas këtij informacioni, në Jugosllavi studionin 25 nxënës e studentë, prej të cilëve 2 vazhdonin Universitetin e Beogradit, të tjerët ndiqnin gjimnaze e shkolla tregtare.<sup>31</sup> Sipas të dhënave të Shtyllës, një pjesë e tyre ishin kundërshtarë të regjimit, madje mbanin lidhje dhe zhvillonin takime me përfaqësues të opozitës shqiptare në Jugosllavi. Për të protestuar ndaj një veprimi të tillë, sekretari i legatës shqiptare kërkoi takim në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, i cili u refuzua.<sup>32</sup>

Masat e marra në fushën e arsimit gjatë viteve të Republikës, bënë të mundur zgjerimin e rrjetit të shkollave fillore nga 447 shkolla në vitin shkollor 1924-1925 u rritën në 536 në vitin 1926-1927. Shkollat e mesme nga 6 shkolla në vitin 1924-1925, shkuan në 10 në vitin 1926-1927. U rrit edhe frekuentimi i nxënësve në shkollat fillore, nga 25.441 në vitin 1924-1925 në 27.770 në vitin 1927-1928. Rritje pati edhe frekuentimi i nxënësve në shkollat e mesme. Nga 728 nxënës që i frekuentonin këto shkolla në vitin 1924-1925, numri i tyre shkoi në 1591 në vitin shkollor 1927-1928.<sup>33</sup> Numri i përgjithshëm i arsimtarëve në shkollat fillore në vitin 1924-1925 ishte 757, në vitin 1926-1927 ishte 803, i atyre në shkollat e mesme në vitin 1925-1926 ishte 64 dhe në vitin 1926-1927 ishte 101.<sup>34</sup> Pavarësisht rritjes së treguesve të mësipërm, sërish ato dëshmojnë se sistemi arsimor ishte larg plotësimin të nevojave arsimore të popullsisë. Në ritmet e ulëta të zhvillimit të arsimit, ndikuan faktorë ekonomikë, politikë, shoqërorë, tradicionalë etj.

Raportet e përgatitura për punën e institucioneve arsimore të këtyre viteve, pasqyrojnë mangësitë në sistemin arsimor dhe vështirësitë që haseshin në veprimtarinë e tij. Aty theksohej se mungesa e teksteve për lëndët e ndryshme të programit unik që kishte filluar të aplikohet në shkollat e mesme, pengonte punën e mësuesve dhe të nxënësve. Kjo, vinte në dukje drejtori i gjimnazit të shtetit në Shkodër, Mirash Ivanaj, i

<sup>30</sup> *Po aty*, V.1928, D.29, fl.70, Telegram i sekretarit të legatës shqiptare në Beograd, Tahir Shtylla drejtuar MPJ, Beograd, 22 .03.1928.

<sup>31</sup> *Po aty*.

<sup>32</sup> *Po aty*.

<sup>33</sup> F. Musaj, *Gruaja në Shqipëri ...* . f. 222; *AMPJ*, V.1926, D.204, fl. 1-2, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit. Pasqyrë përmbledhëse e statistikave arsimore për vitin shkollor 1926-1927.

<sup>34</sup> *Po aty*.

detyronte mësuesit t'u diktonin nxënësve përmbajtjen e mësimeve në formën e leksioneve, gjë që ulte efektivitetin e orës së mësimit<sup>35</sup>. Veç kësaj, ai kërkonte që për lëndët e reja që përmbante programi i shkollave të mesme, të hartoheshin tekste ndihmëse për t'u dhënë nxënësve njohuri paraprake të cilat nuk i kishin marrë në vitet e mëparshme.<sup>36</sup>

Në këtë periudhë nuk u bë e mundur plotësimi i kërkesave për shkolla në krahina të ndryshme të vendit. Në raportin e inspektorisë së arsimit në Shkodër, për vitin shkollor 1926-1927, theksohej se, arsimit si në qytet e veçanërisht në fshat, vuante për mungesën e godinave. Pothuajse  $\frac{3}{4}$  e fshatrave nuk kishin ndërtesa të posaçme dhe mësimi zhvillohej në ambiente të marra me qera të cilat, në shumicën e rasteve ishin të papërshtatshme e me mungesa të theksuara në orenditë e nevojshme për një shkollë.<sup>37</sup> Nevoja për shkolla të reja kishte dhe në zonën e Sarandës, Konispolit etj. Më e theksuar ishte nevoja për çeljen e një shkolle për vajza në Sarandë.<sup>38</sup>

I njëjti shqetësim ngrihej dhe nga drejtorja e shkollës plotore në Konispol. "... Gruaja në krejt qarkun e Çamërisë ka mbetur shumë pas edhe nga shoqet e tjera të Shqipërisë".<sup>39</sup> Prandaj kërkohesh hapja e një shkolle për vajza dhe emërimi i një mësueseje, sepse numri i madh i nxënësve dhe shtimi i rrethave në shkollën plotore ishte i papërbalueshëm. Gjithashtu kërkohesh ngritja e një shkolle të re të përgjithshme, pasi ambientet e medresesë gati 250-vjeçare ku zhvillohej mësimi, ishin të papërshtatshme.<sup>40</sup> Shqetësim shprehej edhe për nivelin arsimor të krejt popullsisë në nënprefekturën e Çamërisë. Niveli i analfabetizimit ishte i lartë, ndërkohë që vetëm 3% e popullsisë prej 10.367 banorë, dinin shkrim e këndim shqip, 2% turqisht dhe 1% greqisht.<sup>41</sup> Në vitin shkollor '27-28 në këtë nënprefekturë kishte një shkollë 4 vjeçare në Konispol dhe 6 shkolla fillore shtetërore me 468

<sup>35</sup> AQSH, F.195, V.1926, D.1, fl.124, Raport i drejtorit të gjimnazit të shtetit Mirash Ivanaj në Shkodër drejtuar DPA, Shkodër, 22.07.1926.

<sup>36</sup> Po aty.

<sup>37</sup> Po aty.

<sup>38</sup> Po aty, F, 195, V.1928, D.369, Raport i drejtorisë së konviktit "Çamëria" drejtuar MA, Sarandë, 7.02.1928.

<sup>39</sup> AQSH, F.195, V. 1928, D. 233, fl.2, Raport i drejtorisë së shkollës plotore Konispol drejtuar MA, Konispol, 4.07.1928.

<sup>40</sup> Po aty.

<sup>41</sup> Po aty.

nxënës, prej tyre 135 ishin vajza.<sup>42</sup> Për të ndihmuar sadopak nxënësit e kësaj krahine dhe për të penguar vajtjen e tyre në shkollat greke, A. Zogu i kërkoi MA që çdo vit 10 nxënësve të kësaj zone, t'u akordohet bursë për të mundësuar vazhdimin e studimit në shkollat teknike e në të tjera të vendit.<sup>43</sup>

Ndonëse në ligj ishte sanksionuar arsimi fillor i detyrueshëm, jo të gjithë fëmijët e moshës 6-13 vjeç e frekuentonin atë. Këshillat mësimore dhe organet e tjera ligjzbatuese nuk e vlerësuan sa duhej zbatimin e tij. Në raportin e inspektorisë arsimore të Elbasanit theksohej se nga moszbatimi i këtij ligji, numri i nxënësve që frekuentonin shkollën fillore vazhdoi të mbetej i ulët. “Në katunde kurdoherë kemi parë xhandarë për të mbledhur punëtorë për rrugë, por askund nuk kemi parë një të tillë me porosi, që të detyrojë popullin me i dërgue fëmijët në shkolla.”<sup>44</sup>

#### **Arsimi në minoritet**

Qeveria shqiptare në vitet e Republikës, çështjen e arsimit të minoriteteve e konsideroi si një problem të rëndësishëm. Në respektim të deklaratës së minoriteteve të Lidhjes së Kombeve (LK) të vitit 1921, në Shqipëri, gjatë viteve 1920-1924, u çelën një numër shkollash në minoritetin grek, malazez dhe arumun. Në vitin shkollor 1924-1925 numri i tyre arriti në 29 shkolla fillore greke në prefekturën e Gjirokastrës, 3 shkolla arumune në atë të Korçës dhe 2 shkolla për pakicën malazeze në Shkodër.<sup>45</sup> Ndërkohë që në vitin 1920, MA kishte kaluar nën përgjegjësinë e saj të gjithë shkollat e minoritetit grek në prefekturën e Gjirokastrës dhe kishte njësuar pagat e arsimtarëve minoritarë me ato të mësuesve shqiptarë.<sup>46</sup>

Politika arsimore e qeverisë shqiptare, synonte arsimimin e minoriteteve në gjuhën amtare dhe përfshirjen e tyre në sistemin arsimor unik të shtetit shqiptar.

<sup>42</sup> *Po aty*.

<sup>43</sup> *Gazeta Dielli* nr. 4027(720) 9.12.1927, Njoftim i Veip Demit.

<sup>44</sup> *AQSH*, F. 195, V. 1926, D.3, fl.151, Raport i inspektorisë arsimore në Elbasan drejtuar DPA, Elbasan, 16.11.1926.

<sup>45</sup> *Po aty*, F.195, V. 1926, D.1, Relacione arsimore të prefekturave të ndryshme për vitin shkollor 1924-1925, 1925-1926.

<sup>46</sup> Beqir Meta, *Minoritet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, Tiranë: “Kristalina-KH”, 2014, f.586.

Në këtë periudhë vëmendje e veçantë iu kushtua minoritetit grek i cili ishte më i madhi në numër, në rreth 2,6% të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë.<sup>47</sup> Ai ishte edhe më i rëndësishmi sepse mbartte probleme delikate që shpesh reflektoheshin për mirë apo për keq në marrëdhëniet shqiptaro-greke. Qarqet politike greke ishin përpjekur për ta shfrytëzuar shkollën në interes të politikës helenizuese në Shqipërinë e Jugut.

Para së gjithash qeverisë shqiptare i duhej të bënte kujdes për shkëputjen e shkollave greke të minoritetit nga propaganda antishqiptare e qarqeve të caktuara greke, të cilat, nëpërmjet programeve e teksteve shkollore dhe mësuesve filogrekë, përçonin tek nxënësit frymën antishqiptare dhe përçarëse midis minoritarëve dhe popullsisë shqiptare të atyre zonave. Në këtë drejtim ajo u përball me vështirësi të shumta, sepse shteti grek, ishte më i fuqishëm ekonomikisht e me përvojë më të gjatë në fushën e arsimit, kishte më shumë mundësi të subvenciononte financiarisht shkollat e minoritetit grek, të paguante më mirë mësuesit, t'i pajiste me tekste mësimore etj.

Për zbatimin e politikës arsimore kombëtare, qeveria shqiptare mbajti kurdoherë parasysh konventën e LK për minoritetet. Kjo konventë shpallte të drejtën e minoritetit për t'u shkolluar në gjuhën amë, por në të njëjtën kohë ajo përcaktonte se gjuha zyrtare ishte e detyruar të mësohej në shkollat e minoritetit dhe se ato ishin të detyruara t'i nënshtroheshin programit mësimor kombëtar dhe shteti kishte të drejtën e ushtrimit të kontrollit.<sup>48</sup> Në pajtueshmëri me këtë konventë, DPA filloi të merrte masa për realizimin e politikës arsimore kombëtare. Në vitin shkollor 1925-1926, u çelën për minoritetin grek 2 shkolla të reja dhe numri i tyre arriti në 31. Po në këtë vit u bënë përpjekje për zbatimin e programit analitik në shkollat e minoriteteve, ashtu si në të gjitha shkollat e vendit. Në këtë kuadër rëndësi iu kushtua mësimit të gjuhës shqipe, e cila zhvillohej në klasën e dytë deri në të katërtën dhe mësimit të lëndëve të historisë e të gjeografisë së Shqipërisë në gjuhën shqipe në klasat e pestë

<sup>47</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III (Periudha e Pavarësisë 28 nëntor 1912-7 prill 1939), Tiranë: "Toena", 2007, f. 30.

<sup>48</sup> *AQSH*, F.148, V. 1927, D. IV-7, Telegram i Ministrisë së Arsimit për Kryesinë e Republikës, Tiranë, 29.11.1927.

e të gjashtë. Pjesa tjetër e programit zhvillohej në gjuhën greke.<sup>49</sup> Realizimi i programit të këtyre lëndëve, kërkonte përzgjedhjen dhe emërimin e mësuesve të aftë të gjuhës shqipe dhe të lëndëve histori e gjeografi të Shqipërisë, të cilët, me punën e përkushtimit të tyre, do të ngjallnin interes tek nxënësit për gjuhën shqipe, do të futnin tek ata dashurinë dhe respektin për historinë e popullit shqiptar dhe për Shqipërinë.

Jani Minga inspektor i arsimit në Gjirokastrë, e shihte të pamundur zbatimin e këtij programi nga mësues të minoritetit të cilët nuk e zotëronin mirë gjuhën shqipe. Madje, një pjesë e tyre theksonte ai, edhe pse paguhen nga shteti shqiptar, duke i dhënë rëndësi gjuhës greke, e mësonin gjuhën shqipe “sa për sy e faqe dhe në mos për qeshje.”<sup>50</sup> Prandaj, ai i propozoi DPA, të zgjidhte dhe të emëronte mësues që e dinin mirë jo vetëm gjuhën greke, por dhe atë shqipe.<sup>51</sup> Në pamundësi për të mbuluar programin e këtyre lëndëve me mësues shqiptarë, DPA në bashkëpunim me inspektorin e arsimit në Gjirokastrë, zgjodhi midis mësuesve minoritarë më të aftët, që e njihnin mirë gjuhën shqipe. Gjithashtu ajo mbajti qëndrim ndaj atyre mësuesve minoritarë, të cilët paguheshin nga shteti shqiptar por financoheshin edhe nga shteti grek duke u bërë përçues të interesave të tij. Ndaj tyre, por edhe ndaj disa mësuesve shqiptarë, u bënë hetime për veprimtari në kundërshtim me interesat e shtetit dhe u morën masa deri në pushimin nga puna si në Bularat, në Leshnicë etj.<sup>52</sup> Gjithashtu u bënë zëvendësime të mësuesve minoritarë, të cilët në të kaluarën kishin premtuar të jepnin mësimin e gjuhës shqipe, dhe ishin treguar të paaftë. Ata u zëvendësuan me mësues më të aftë po nga minoriteti. Lëvizje e transferime të tilla u bënë në Jergucat, Bularat, Labovë, Delvinë e Konispol etj. Këto masa forcuan punën për mësimin e gjuhës shqipe dhe zbatimin e programit kombëtar

<sup>49</sup> *Po aty*, Telegram i Ministrisë së Arsimit për Kryesinë e Republikës, Tiranë, 3.11.1927; *Po aty*, F.152, V.1925, D.166, fl.166, Informacion i nënprefektit të Gjirokastrës Zef Kadarja, drejtuar MPB, Gjirokastrë, 6.9.1925.

<sup>50</sup> *Po aty*, F.195, V.1925, D.37, fl. 123, Raport i inspektorisë arsimore në Gjirokastrë drejtuar DPA, Gjirokastrë, 21.7.1925.

<sup>51</sup> *Po aty*.

<sup>52</sup> *AQSH*, F.152, V.1925, D. 166, fl. 90-91, Telegram i prefektit të Gjirokastrës drejtuar MPB, Gjirokastrë, 11.4.1925; *po aty*, fl.107, Informacion i prefektit të Korçës Hilë Mosi drejtuar MPB mbi sjelljen e mësuesit J. Iliadhi në Hoçisht i pushuar nga puna, Korçë, 28.VIII.1926.

në shkollat e minoritetit.<sup>53</sup> Në raportet arsimore, J. Minga vinte në dukje se në shkollat greke, shtetërore e private, vërehej një përparim dhe interes i veçantë për mësimin e gjuhës shqipe si nga nxënësit ashtu dhe nga mësuesit.<sup>54</sup> Kjo ishte pritur pozitivisht edhe te banorët minoritarë. Tek ata kishte filluar të fashitej mentaliteti kundërshtues për gjuhën shqipe që ishte shfaqur më parë. Edhe organet drejtuese vendore dhe trupa pedagogjike në konferencat e oganizuara për çështjet e arsimit, kishin shprehur dëshirën për mësimin e gjuhës zyrtare sepse e shihnin si një mjet të rëndësishëm për të plotësuar interesat e tyre, për t'u integruar në jetën politike e shoqërore dhe për të kontribuar në zhvillimin e shtetit të tyre të përbashkët.<sup>55</sup>

Për t'i çuar më tej këto arritje, Jani Minga propozonte që për vitin mësimor 1926-1927 të emëroheshin mësues shqiptarë të zotë në zonat grekofone të Dropullit të Sipërm dhe Pogonit për t'u mësuar nxënësve dy gjuhët, shqip dhe greqisht, të çelëshin kurse për mësimin e gjuhës shqipe nga mësuesit greqishtfolës, të mbështeteshin me bursa të shtetit djem të varfër e të shkathët nga këto krahina për të studiuar në Normalen e Elbasanit, të cilët në të ardhmen do të shërbenin si mësues e do të zhvillonin mësimin me një frymë thjesht kombëtare.<sup>56</sup> Veçanërisht ai kërkonte forcimin e arsimit kombëtar dhe të mësimin të gjuhës shqipe në shkollën e Bularatit e të Koshovicës (në Dropullin e Sipërm) dhe në Poliçan e Sopik të qarkut të Pogonit të cilat sipas tij ishin qendra të forta të helenizmit.<sup>57</sup> Në qarkun e Delvinës, inspektori J. Minga në bashkëpunim me pleqësitë e katundeve të këtij qarku, propozuan për mësues të gjuhës shqipe, Jorgo Mekshin në shkollën e Dhrovjanit, një normalist shqiptar në qytetin e Delvinës, Qiriako Dilo në Poliçan, Pavllo Cimbi në Sopik etj.<sup>58</sup>

Një çështje, për të cilën J. Minga i tërhoqi vëmendjen Drejtorisë së Përgjithshme, ishte hapja dhe forcimi i shkollave kombëtare në fshatrat e

<sup>53</sup> *Po aty*, F.195, V.1927, D.74, fl.1, Telegram i MA, drejtuar drejtorisë së shkollës Libohovë, mbi mësimin e gjuhës shqipe në shkollat e katundeve Jergucat, Bularat, etj, Tiranë, 10.11.1927.

<sup>54</sup> *AQSH*, F.195, V. 1926, D. 3, fl. 187-190, Raport i inspektorisë së Gjirokastrës, mbi shkollat grekofone qeveritare e private të Dropullit të Sipërm, Gjirokastër, 28. 4.1926.

<sup>55</sup> *Po aty*.

<sup>56</sup> *Po aty*.

<sup>57</sup> *Po aty*, fl.185, Vërejtje mbi shkollat grekofone të qarkut të Pogonit.

<sup>58</sup> *Po aty*, F.195, V.1926, D.3, fl. 217-218, Raport i inspektorisë së arsimit në Gjirokastër drejtuar DPA, Gjirokastër, 22.8.1926.

banuara tërësisht me shqiptarë brenda zonës minoritare dhe në ato kufitare me Greqinë. Në këtë mënyrë shmangej rreziku i asimilimit dhe nxënësve shqiptarë u krijohet mundësia për t'u shkolluar në gjuhën shqipe.<sup>59</sup>

Në qershor të vitit 1927, ministri Xh. Ypi në zbatim të politikës arsimore të qeverisë në shkollat e minoritetit, në kuadër të përgatitjeve të vitit shkollor 1927-1928 i kushtoi vëmendje përzgjedhjes së personelit mësimdhënës. Lista e arsimtarëve e propozuar nga komuniteti minoritar dhe autoritetet arsimore të Gjirokastrës për këtë vit shkollor, iu nënshtrua një studimi dhe verifikimi të hollësishëm, për të emëruar mësues shqiptarë njohës të mirë të dy gjuhëve dhe të aftë për t'iu përgjigjur më mirë programit të arsimit kombëtar. Kjo përkujdesje bëri që ky vit mësimor, të fillonte me vonesë në disa shkolla të minoritetit.

Masat e mara nga qeveria shqiptare për përfshirjen e shkollave të minoritetit në sistemin e arsimit unik kombëtar të cilat ishin në pajtueshmëri me konventat ndërkombëtare për minoritetet, u kritikuan nga autoritetet shtetërore dhe shtypi grek. Gazeta greke "Estia" i konsideronte ato si përpjekje të qeverisë shqiptare për mbylljen e shkollave minoritare dhe në kundërshtim me interesat e minoritetit e gjuhës greke në Shqipëri.<sup>60</sup> Gazeta "Politea" shkante dhe më tej. Ajo njoftonte se qeveria shqiptare kishte urdhëruar mbylljen e shkollave të minoritetit dhe këtë veprim e konsideronte si të iniciuar nga Italia dhe si mbështetje të saj për A. Zogun. Sipas saj "Italia drejtonte politikën në Tiranë. Ky inkurajim ka shkuar deri atje sa të kaloreshin caqet dhe të ndërhyhet me xhandarmëri për të ndaluar mësuesit të flisnin greqisht në ambientet e shkollës."<sup>61</sup> Ajo i bënte thirrje Ministrisë së Arsimit të Greqisë që në reciprocitet të mos u lëshonte pasaportat nxënësve shqiptarë që studionin në Greqi, pa depozituar më parë 10 mijë franga ar.<sup>62</sup>

Duke shfrytëzuar keqinterpretimet për masat e qeverisë shqiptare, sillogjet epirote të Athinës reagues në mënyrë më të ashpër. Të mbledhur në Pire, ata protestuan kundër "ndjekjes" që autoritetet shqiptare po

<sup>59</sup> *Po aty*.

<sup>60</sup> *AMPJ*, V.1927, D. 208, fl.1, Telegram i legatës shqiptare në Athinë drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme Hysen Vrioni, Athinë, 20. 12. 1927.

<sup>61</sup> *Po aty*, fl.18, gazeta *Politea*, 24.11.1927.

<sup>62</sup> *Po aty*.

kryenin ndaj elementit grekofon në Shqipëri dhe e çuan çështjen në LK.<sup>63</sup> Kjo fushatë u mbështet edhe nga deputeti i Janinës në Parlamentin Grek dhe nga legata greke në Shqipëri. Madje, kjo e fundit i dërgoi një letër qeverisë shqiptare ku i kërkonte rregullimin e shkollave greke në Shqipëri.<sup>64</sup>

Në dokumentet e kohës, dëshmohet edhe për një nacionalizëm të tepruar i shfaqur nga segmente të veçanta të pushtetit lokal në Gjirokastrë. Kështu prefekti i Gjirokastrës kërkoi largimin e kryemësuesit të shkollës së Sarandës Kost Cinxo nga detyra dhe transferimin e tij jashtë saj, vetëm se ai fliste me të shoqen greqisht në tregun e qytetit. Qëndrimin e tij në Sarandë ku popullsia ishte thjeshtë shqiptare ai e konsideronte të papajtueshëm me masat që po merreshin nga qeveria për “nacionalizimin” e Sarandës. Gjithashtu në disa shkolla të Libohovës xhandarmëria gjatë kontrollit për të verifikuar prezencën e mësuesve dhe të nxënësve, u kishte kërkuar atyre që të mos përdornin gjuhën greke brenda dhe jashtë shkollës. Përfaqësuesit e këtyre fshatrave u ankuan në Komandën e Përgjithshme të Xhandarmërisë dhe kërkuan që të ndaloheshin veprimet e kundërligjshme të saj.<sup>65</sup> Veprime të tilla ishin raste të veçuara, ndaj të cilave reagoi ashpër Presidenti i Republikës. Ai kërkoi hetimin e çështjes dhe të informohej për përfundimin e saj.<sup>66</sup>

Qeveria shqiptare, me argumente konkrete, i hodhi poshtë pretendimet e shtetit grek. Ajo informoi sekretarin e Përgjithshëm në LK, Kolban (Colban) se gjatë viteve të Republikës Shqiptare, numri i shkollave grekofone në Shqipëri ishte dyfishuar, nga 31 në vitin 1925-1926, në 70 në vitin 1927-1928. Në to jepnin mësim mbi 97 mësues. Për mbajtjen dhe funksionimin e tyre shteti shqiptar shpenzonte 63.440 franga ar deri në 70.000 franga ar.<sup>67</sup> Këto të dhëna zyra e shtypit në Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ), ia dërgoi trupit diplomatik shqiptar në vende të ndryshme, për të dëshmuar se si një shtet i Ballkanit,

<sup>63</sup> AMPJ, V.1927, D. 208, fl.13, Telegram i zyrës së shtypit drejtuar prefekturave dhe gazetës “Telegraf”, Tiranë, 17.11.1927.

<sup>64</sup> Po aty, V. 1928, D. 290, fl. 55, Notë e legatës greke, drejtuar MPJ, Tiranë, 4.11.1928.

<sup>65</sup> AQSH, F.77, V. 1927, D. 69, Ankesë e përfaqësuesve të fshatrave Jergucat, Zervet, Bularat, etj, drejtuar Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë, Tiranë, 2 12.1927.

<sup>66</sup> Po aty.

<sup>67</sup> AMPJ, V.1927, D. 208, fl.13, Telegram i zyrës së shtypit drejtuar prefekturave dhe gazetës “Telegraf”, për përgënjeshttrimin e lajmeve të Athinës dhe shtypit grek, Tiranë, 17.11.1927.

respektonte traktatin e minoriteteve të LK.<sup>68</sup> Në të njëjtën kohë MA i dërgoi MPJ, listën e mësuesve të shkollave të minoritetit, duke sqaruar se asnjë mësues grekofon nuk ishte pushuar nga puna siç pretendohet nga shtypi grek, por ishin transferuar për nevoja të arsimit.<sup>69</sup> Gjithashtu, Xh.Ypi informoi MPJ dhe KM se, në kundërshtim me pretendimet e palës greke, në atë vit shkollor ishte rritur numri i personelit mësimor të paguar nga shteti dhe i mësuesve të tjerë që paguheshin nga komuniteti. Mësimet zhvilloheshin rregullisht dhe masat e marra nga MA, kishin siguruar që në të gjitha shkollat të mësohej gjuha greke dhe ajo zyrtare duke i qëndruar korrekt të drejtave të minoritetit në bazë të artikulli 6 të deklaratës së LK.<sup>70</sup> Për të qetësuar situatën dhe për të mos acaruar më tej marrëdhëniet më shtetin fqinj, A. Zogu porositi ministrin e Arsimit të ruante *status quonë* e shkollave grekofone dhe të sigurote vijueshmërinë normale në to. Madje ai, në një kohë kur po punohej për t'i dhënë arsimit në shkollat grekofone karakter kombëtar, në fund të vitit 1927, lejoi që në qytetin e Sarandës, pa minoritarë, të hapej një shkollë greke.<sup>71</sup> Këtë veprim të A. Zogut gazeta “Estia” e paraqiti si mbajtje të një premtimi që ai i kishte bërë disa muaj më parë misionit të Ekzarkut të Thronit Igumenik, mitropolitit të Trapezundit, Krisanthos, lidhur me rregullimin e kishës ortodokse.<sup>72</sup> Mesa duket, A. Zogu e vlerësoi si më të rëndësishme autoqefalinë e Kishës Ortodokse Shqiptare se sa çeljen e një shkolle fillore greke.

Reagimi i menjëhershëm i institucioneve shqiptare ndaj propagandës greke, gjeti mbështetje edhe nga shtypi shqiptar jashtë vendit, ku dallohet gazeta “Dielli” e shqiptarëve të Amerikës. Aty u vlerësuan masat e marra nga qeveria shqiptare për lirinë e veprimtarinë e shkollave të minoritetit grek.<sup>73</sup>

E gjithë ofensiva propagandistike greke ndaj qeverisë shqiptare, synonte të largonte vëmendjen nga politika arsimore që qeveria greke ndiqte ndaj minoritetit shqiptar në Greqi. Ministri grek i Punëve të Jashtme Politis, më 1926 kishte deklaruar në LK, se e njihte Çamërinë e

<sup>68</sup> *Po aty*, fl.15, Telegram i MPJ drejtuar legatave shqiptare, Tiranë, 17.11.1927.

<sup>69</sup> *AMPJ*, V. 1928, D. 290, fl.2, Telegram i MA, drejtuar MPJ, Tiranë, 30.01.1928.

<sup>70</sup> *Po aty*, fl. 64, Telegram i Xh.Ypit drejtuar KM, Tiranë, 24.10.1928.

<sup>71</sup> *Po aty*, V.1927, D. 208, fl. 2, *Gazeta Estia*, 19.12.1927.

<sup>72</sup> *Po aty*.

<sup>73</sup> *Gazeta Dielli*, nr. 4041(734) 27 janar 1928, f. 2, Letër e Argondizzës mbi minoritetet në Shqipëri.

çamët si minoritet dhe u angazhua se do të respektonte të gjitha të drejtat e tyre sipas traktatit të minoriteteve. Madje, në nëntor të këtij viti, ai i kishte premtuar kreut të legatës shqiptare në Athinë, Stavro Stavri, se do të plotësonte kërkesën e parisë së Margëlliçit për të çelur një shkollë shqipe<sup>74</sup>. Por, në këtë drejtim nuk ishte hedhur asnjë hap. Nisur nga këto premtime, paria e Margëlliçit i kërkoi legatës shqiptare në Athinë të ndërhynte pranë administratës greke për të bërë të mundur çeljen e shkollës shqipe<sup>75</sup>. Edhe Ministria shqiptare e Punëve të Jashtme reagoi ndaj qëndrimit të Greqisë. “Meqënëse sekretaria e LK, - theksohej në deklaratën e saj,- ishte në korent të respektimit të traktatit për minoritetet në Shqipëri, duket qartë se qarqet greke kanë si qëllim të mbytin të vërtetën e të sjellin ftohtësi në marrëdhëniet e sinqerta shqiptaro-greke, aq më tepër kur shpresohet që qeveria greke do të zbatojë premtimin që ka dhënë për të përmirësuar gjendjen e minoritetit shqiptar në Greqi.”<sup>76</sup> Duket se qëndrimi i Greqisë ishte edhe një presion ndaj qeverisë shqiptare lidhur me bisedimet që priteshin të zhvilloheshin midis delegacioneve të të dy vendeve në Athinë, për çështjen e pronave të shqiptarëve në Greqi.<sup>77</sup>

Të njëjtën politikë arsimore shteti shqiptar ndoqi edhe ndaj shkollave të minoritetit malazez në Shkodër dhe të pakicës arumune. Sipas të dhënave të shtypit rumun, qysh para vitit 1900 ekzistonte një gjimnaz me konvikt dhe shkollë fillore arumune në Berat, ndërsa në Elbasan ekzistonte para vitit 1910. Pas Shpalljes së Pavarësisë deri në Luftën e Parë Botërore, shkolla arumune ishin çelur në Voskopojë, Lenge, Nicë, Grabovë e Vithkuq.<sup>78</sup> Ndërsa, sipas të dhënave statistikore, të përgatitura nga prefekturat për vitin shkollor 1924-1925, në Shqipëri funksionin tre shkolla arumune, në Korçë, Shpëskë e Plasë.<sup>79</sup>

Në uljen e numrit të shkollave për arumunët veç situatave të trazuar që kaloi vendi pas Shpalljes së Pavarësisë deri në fillim të viteve ‘20,

<sup>74</sup> AMPJ, V.1927, D. 208, fl.1, Telegram i legatës shqiptare në Athinë drejtuar MPJ, Athinë, 20.12.1926.

<sup>75</sup> Po aty.

<sup>76</sup> Po aty, V.1927, D. 208, fl.13, Informacion i MPJ drejtuar prefekturave dhe gazetës “Telegraf”, Tiranë, 17.11.1927.

<sup>77</sup> Gazeta Dielli nr. 4041(734), f. 2.

<sup>78</sup> AMPJ, V.1927, D. 208, fl. 34; Ioan Dragu, “Qeveria shqiptare kundër të fundmeve shkolla rumune”, Gazeta Dimineata, 14.10.1927.

<sup>79</sup> AQSH, F.195, V.1926, D. 1, Relacione të inspektorive të arsimit në prefektura të ndryshme për gjendjen arsimore në vitin shkollor 1924-1925 dhe 1925-1926.

ndikoi dhe rimëkëmbja e shtetit shqiptar dhe përpjekjet për forcimin e shkollës kombëtare. Arumunët tashmë e shihnin të ardhmen e tyre të lidhur ngushtë me integrimin në shoqërinë shqiptare. Kjo bëri që ata të afroreshin më shumë me elementin shqiptar, pra dhe me shkollën shqipe sesa t'u qëndronin fanatik elementëve të identitetit si pakicë etno-kulturore. Kështu e vlerësuan më me interes arsimimin e fëmijëve në shkollat shqipe dhe si një mundësi më shumë për integrimin në jetën ekonomike, politike e shoqërore të vendit. Këtë qasje të tyre, e shpreh edhe gazetari rumun Joan Dragu, i cili në vitin 1927 vizitoi Shqipërinë. Nga kontaktet që ai pati me shqiptarë dhe arumunë, konstatoi se "... atyre [arumunëve], u pëlqen kur zyrtarët i konsideronin shqiptarë. Ata e dinë se nëse nga një anë cilësimi si minoritarë mund t'i japë një qytetari e disa përfitime kolektive shkollore e fetare, nga ana tjetër ky cilësim mund të shkaktojë një vetmi të minoritetit, një kufizim të dyerve të hapura ndaj lirive morale e shoqërore, përfitimeve materiale të cilat i gëzojnë sot."<sup>80</sup> Gazetari rumun bën me dije se në procesin e integrit arumunët ishin mirëpritur edhe nga shteti shqiptar. Një nga funksionarët e lartë të shtetit i kishte deklaruar, se arumunët ishin shumë të dëshiruar nga shqiptarët jo vetëm për cilësitë e përbashkëta midis tyre, por se ata përfaqësonin një popull me të cilin populli shqiptar kishte jetuar në marrëveshje të plotë dhe se ishin treguar qytetarë besnikë dhe punëtorë.<sup>81</sup> Në këtë këndvështrim arumunët ishin asimiluar dhe nuk kishin interes të dalloheshin prej tyre sepse theksonte ai "... nëse shqiptarët me origjinë rumune, do të konsideroheshin minoritet, gjithë ajo dashuri, besim nuk mundet më, të qëndrojnë në shpirtin tonë dhe përfitimet të cilat i gëzojnë sot aq krerë rumunë (në drejtim të shtetit, të sipërmarrjeve dhe në administratë) do të zvogëloheshin në atë masë që ata nuk do të dëshironin".<sup>82</sup>

Qeveria rumune, e interesuar për të ruajtur dhe forcuar influencën kulturore dhe fetare rumune në komunitetin arumun në Shqipëri, në tetor 1926, nxiti drejtorinë e shkollës arumune në Korçë, e cila pa një marrëveshje paraprake dhe pa miratim të DPA, shtoi një klasë lice ku jepnin mësim mësues rumunë, që nuk paguheshin nga shteti shqiptar.

<sup>80</sup> AMPJ, V. 1927, D. 208, fl. 31-34; I. Dragu, "Qeveria shqiptare ...", 14.10.1927.

<sup>81</sup> AMPJ, V. 1927, D. 208, fl. 31-34.

<sup>82</sup> Po aty, fl. 40.

Shkollat arumune vepronin me program kulturor rumun.<sup>83</sup> Një veprim i tillë ishte në kundërshtim me ligjin për arsimin e minoriteteve.

Në korrik 1927, me propozim të Xh. Ypit, qeveria vendosi që shkollat arumune t'i nënshtroheshin programit kombëtar, të hiqej klasa lice në shkollën arumune të Korçës dhe të mbeteshin shkollë fillore, të largoheshin mësuesit që nuk kishin nënshtetësi shqiptare dhe të emëroheshin mësues shqiptarë të paguar nga shteti e të zgjedhur nga komuniteti vendas.<sup>84</sup> Vendimi u zbatua në gusht të atij viti dhe në të njëjtën kohë, në procesin mësimor të tyre u fut programi arsimor kombëtar. Personeli dhe nevojat e shkollës do të përballoheshin nga shteti shqiptar.<sup>85</sup>

Në vitin shkollor 1927-1928, me kërkesë të këtij komuniteti qeveria hapi një shkollë tjetër arumune në Korçë dhe për të shmangur incidentet e panevojshme me shtetin rumun, lejoi gjuhën rumune si gjuhë fakultative në liceun e Korçës.<sup>86</sup>

Megjithatë qeveria dhe shtypi rumun reagues ndaj masave të mësipërme të qeverisë shqiptare. Gazeta "Adverul" i konsideroi ato si shovinizëm dhe mosmirënjohje ndaj shtetit rumun, i cili kishte ndihmuar Rilindjen Kombëtare dhe shtetin shqiptar në vijimësi.<sup>87</sup> I njëjti reagim erdhi edhe nga gazeta "Universul".<sup>88</sup> Ndërsa shoqëria e studentëve "Macedo-roumaine" në protestën botuar në gazetën "Viitorul", i bënte thirrje qeverisë shqiptare të rishikonte masat dhe të respektonte të drejtat e rumunëve në Shqipëri.<sup>89</sup> Në përgjigje të këtyre shkrimeve që nuk i përgjigjeshin aspak të vërtetës, qeveria shqiptare i dërgoi një letër sqaruese homologues së saj rumune, ku e vinte në dijeni se masat e mara në shkollat arumune, ishin në pajtueshmëri të plotë me artikullin 6 të deklaratës për minoritetet të LK dhe se shkollat arumune, jo vetëm që nuk ishin mbyllur, po ishin shtuar dhe me tre shkolla të tjera për atë vit shkollor. Këtë njoftim gazeta "Universul" e konsideroi si një lajm që do

<sup>83</sup> AMPJ, V. 1927, D. 208, fl. 40.

<sup>84</sup> Po aty, fl. 27, Vendim i KM, nr. 254, Tiranë, 26.7.1927.

<sup>85</sup> Po aty, fl. 26, Telegram i MA, drejtuar MPJ, Tiranë, 2.8.1927.

<sup>86</sup> Po aty.

<sup>87</sup> Po aty, fl.132; Sh. N. Batzaria, "Xhesti i qeverisë shqiptare", gazeta *Adverul*, Bukuresht, 13.11.1927.

<sup>88</sup> AMPJ, V.1927, D. 208, fl.47; "Mbi mbylljen e shkollave arumune në Shqipëri", gazeta *Universul*, Bukuresht, 23.10.1927.

<sup>89</sup> AMPJ, V.1927, D. 208, fl.44; "Protestë kundër mbylljes së shkollave rumune në Shqipëri", gazeta *Viitorul*, Bukuresht, 18.10.1927.

të gëzonte në mënyrë të sigurtë dhe do të risillte qetësi në shpirtin e paqetësuar të rumunëve.<sup>90</sup>

Situatën e krijuar, qeveria rumune e shfrytëzoi për të ushtruar presion ndaj qeverisë shqiptare për ta trajtuar komunitetin arumun si minoritet kombëtar. Rumunët pretendonin se në Shqipëri ekzistonte një komunitet rumun prej 60-65 mijë banorë.<sup>91</sup> Por në të dhënat e autorëve të ndryshëm numri i tyre shkonte nga 20 deri në 30 mijë.<sup>92</sup> Ajo insistoi pranë qeverisë shqiptare që atyre t'u njiheshin të drejta më të zgjeruara ashtu si minoritetit grek. Në fillim të janarit, ministri rumun në Tiranë, i kërkoi MPJ kalimin e administrimit të shkollave nga shteti në dorë të komunitetit arumun, mësuesit të propozoheshin prej tij dhe të miratoheshin nga MA. Në të njëjtën kohë ai kërkoi nga qeveria shqiptare që shkolla dhe kisha rumune të mbaheshin nga komuniteti dhe, me pëlqimin e saj, të merrnin ndihma nga shteti rumun.<sup>93</sup> Ministri i Jashtëm, i propozoi KM që të plotësoheshin kërkesat e palës rumune, për të mos ftohur marrëdhëniet me të, sepse Rumania, përveçse luante rol të rëndësishëm në Antantën e Vogël, ishte pjesë e tryezave ku tërhiqej mendimi për çështjet që i përkisnin Ballkanit. Kjo, sipas tij, do të ndikonte që Rumania në LK do të qëndronte në krah të Shqipërisë dhe jo kundra saj. Në të njëjtën kohë do të shërbente edhe si shenjë mirënjohjeje për ndihmën që shteti rumun i kishte dhënë Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.<sup>94</sup>

Por ministri i Arsimit e kundërshtoi sugjerimin e MPJ, duke arsyetuar se nuk mund të pranohej kërkesa për autonomi të shkollës arumune sepse kjo do të përbënte një precedent që mund të shfrytëzohej dhe nga minoritetet e tjera.<sup>95</sup> “Shkollat arumune që veprojnë sot, deklaronte Xh.Ypi, kanë personel të aftë që janë nënshtetas shqiptar dhe i sigurojnë popullsisë vllahe kulturën në gjuhë amtare. Financimi nga shteti rumun ishte i panevojshëm sepse ato siguroheshin nga buxheti i

<sup>90</sup> AMPJ, V.1927, D. 208, fl. 68-69; “Çështja e shkollave rumune në Shqipëri” gazeta *Universul*, Bukuresht, 17.12. 1927.

<sup>91</sup> AMPJ, V.1927, D. 208, fl.35-36; “Qeveria shqiptare kundër të fundmeve shkolla rumune”, gazeta *Dimineata*, Bukuresht, 14.10.1927.

<sup>92</sup> B. Meta *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar ...*, f. 62.

<sup>93</sup> AMPJ, V.1928, D. 290, fl. 23, Raport i MPJ drejtuar Kryesisë së KM, Tiranë, 10.1.1928.

<sup>94</sup> *Po aty*, fl. 25.

<sup>95</sup> AQSH, F.149, V.1928, D. IV-221, fl.5, Telegram i MA drejtuar KM, Tiranë, 4.2.1928.

shtetit.”<sup>96</sup> Sipas tij, qeveria rumune mund ta siguronte kulturën rumune në këtë komunitet, nëpërmjet bursave që mund t’u akordonte studentëve arumunë për të studiuar në Rumani.<sup>97</sup>

Të njëjtat masa u morën në vitin shkollor 1927-1928 edhe në shkollat e minoritetit malazez në Shkodër dhe në Vrakë. U larguan mësuesit me nënshtetësi jugosllave të cilët u zëvendësuan me mësues shqiptarë të paguar nga shteti dhe u futën lëndët e programit arsimor kombëtar si mësimi i gjuhës shqipe, historia dhe gjeografia e Shqipërisë.<sup>98</sup>

### *S u m m a r y*

#### EDUCATION IN ALBANIA AND THE MEASURES FOR ITS IMPROVEMENT (1925-1928)

In the second part of the article “Education in Albania and the measures for its improvement (1925-1928)”, which follows from the previous number, are treated and analyzed Albanian government’s measures to reform further the education system, to complete the legal framework and multiple tasks laid down for the making of a common national education. Insufficient capacity of the General Directorate of Education to deal with them, posed the need for the establishment of the Ministry of Education, which was achieved by the decision of the Council of Ministers in June 1927. Further, it is reflected the activity of the Education Ministry as well as the contribution of minister Xhafer Ypi for the implementation of law for the categorization of teachers, organic law for the education system and meeting the demands from different regions of the country to open schools, teachers’ staff, teaching tools etc. To fulfill the needs for the developing the country, the attention was paid to the development of professional education for guys and for girls. But, the decision to extend it by reducing the number of gymnasiums arguing that students prepared at this sort of schools will cause the boring of the political regime in the power was harmful because it impedes the development of the country’s intelligence. This measure was criticized by the intellectual circles of the country especially from teachers who through protests forced it to be withdrawn. Based on statistical data of the Ministry of Education, it appears that despite the difficult economic

<sup>96</sup> *Po aty.*

<sup>97</sup> *Po aty.*

<sup>98</sup> *Po aty.*, F. 195, V. 1928, D. 45, fl. 1-3, Telegram i MA drejtuar MPB, Tiranë, 2.02.1928.

and social conditions in which was the country during 1925-1928, the education system marked some progress, such as the increase of the number of primary and secondary schools, increasing of the students enrollment, as well as a slight increase in the number of teachers. Another important direction in educational policy of the government in this period was caring for the development of minority's education in Albania by increasing the number of schools in their own language and involving them in a common public educational system. A special attention was paid to the Greek minority who had the greater number amounting to 2.6% of the population. Maintaining correctly to the League of Nations convention on minorities, in all schools of minority it was strengthened demand for the Albanian language, for the subjects of history and geography of Albania as well as the appointment of Albanian and minority teachers who knew well both Greek and Albanian languages. The same policy was also followed for Aromanian and Montenegrin schools in country. Albanian government's educational policy was opposed by Greek and Romanian government, which considered it as a violation of the rights of minority for education. But, the Albanian government rejected them, defended its correct position and its right on education of minorities in Albania to the League of Nations too.

